

URDHËR
Nr. 2, datë 7.1.2026

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE TË TITULLARIT TË AUTORITETIT
KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 25, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 11, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 73, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor te znj. Florenca Korbi, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, për të gjitha procedurat e prokurimit publik të Ministrisë së Financave.
2. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen nga data 7.1.2026.
3. Urdhri nr. 116, datë 15.8.2024, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohet.
4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj